



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRI E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

**SHPALLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:
PËRGJEGJËS I SEKTORI TË KËRKIM DHE ZHVILLIM
DREJTORIA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE, PARTNERITETIT DHE
KËRKIMIT**

1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:

Emërtesa e pozicionit: Përgjegjës i Sektorit të Kërkim dhe Zhvillimit

Klasa e pagës: III-1

Drejtoria: Drejtoria e IHD, Partneritetit dhe Kërkimit

Raporton te: Drejtori i Drejtorisë së IHD, Partneritetit dhe Kërkimit dhe Drejtori Ekzekutiv

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT: Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimit dhe Zhvillimit në kuadër të investimeve të huaja direkte fokusohet rreth kërkim analizës dhe inovacionit për të orientuar dhe lehtësuar sektorin e IHD me të dhëna dhe strategji targetimi, promovimi dhe propozim projektsh konkrete tek investitorët bazuar në sektorin ku i përkasin dhe shtetin ku operojnë.

3. DETYRAT KRYESORE:

- Kryen kërkime të thelluar mbi tendencat globale të investimeve, teknologjitë në zhvillim dhe inovacionet e industrisë për të orientuar mundësitë për tërheqjen e investimeve të huaja.
- Analizim të sektorëve ose industrive specifike për të vlerësuar potencialin e tyre për investime dhe identifikimin e lojtarëve kryesorë, avantazhet konkurruese dhe fushat për bashkëpunim.
- Zhvillon strategji dhe iniciativa për të promovuar mundësitë e investimeve për investitorët e huaj potencialë, duke përfshirë korporatat shumëkombëshe, institucionet kërkimore dhe startup-et e teknologjisë.
- Siguron të dhëna dhe rekomandime për politikëbërësit mbi politikën, rregulloret dhe stimujt për të mbështetur investimet, për të nxitur inovacionin dhe për të forcuar ekosistemin e kërkim dhe zhvillim
- Harton dhe zbaton programe nxitëse, grante dhe mekanizme financues për të nxitur investimet dhe aktivitetet e inovacionit nga investitorët e huaj.
- Kultivon partneritete dhe bashkëpunime me institucionet kërkimore, universitetet, parqet teknologjike dhe qendrat e inovacionit për të përmirësuar ekosistemin dhe për të tërhequr investime të huaja.
- Angazhohet me palët e interesuara ndërkombëtare, duke përfshirë agjencitë qeveritare, shoqatat e industrisë dhe grupet e teknologjisë, për të promovuar mundësitë e investimeve dhe për të nxitur bashkëpunimin.

- Zhvillon programe të trajnimit, seminareve dhe nismave për shkëmbimin e njohurive për të ndërtuar kapacitetin e palëve të interesuara vendore në tërheqjen, lehtësimin dhe menaxhimin e investimeve të huaja.
- Ndjek flukset hyrëse të investimeve, monitorimin e progresit dhe ndikimit të projekteve dhe vlerësimi i efektivitetit të strategjive promovuese për të informuar vendimmarrjen dhe rregullimet strategjike.
- Përpilon dhe analizon të dhëna, përgatit raportet dhe mban e dokumentacionit në lidhje me aktivitetet e investimeve, projektet dhe rezultatet për përdorim të brendshëm dhe qëllime raportimi.

4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

5. KËRKESAT E POSAÇME:

Arsimi: Master shkencor në administrim biznesi, shkencë politike, komunikimi, ekonomike, kompjuterike, informatikë si dhe diploma ose çertifikata të avancuara në lidhje me fushën e përgjegjësisë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën e kërkuar.

Tjetër: Të ketë njohuri në fushën e metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe/ose analitike. Të ketë aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale. Të ketë aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, si dhe për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale. Të ketë aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre. Të ketë njohuri të gjuhës angleze; njohja edhe e gjuhëve të tjera përbën avantazh.

6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;

- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim, dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(26.02 .2025 afati i fundit i aplikimit)**.

7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në vijim, AIDA do të realizojë:

1- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;

a- nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.

b- nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;

2 - Faza e dytë e konkurrimit është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve

të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.